

AKT THEMELIMI
I SHIQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CLA RENT “ SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 10.02.2022, une e nënshkruara:

1. **Drita BERISHA**, qytetare italiane, e datëlindjes 10.04.1995, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi CA15491GB themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

“CLA RENT “ SHPK

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 2: Selia

Lagjja 17, Spitalle, Zona Kadastrale 8517, Nr.Pasurie 171/193, Durrës.

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Dhënie makinash me qira.
- Blerje dhe shitje e mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove. Import, eksport.
- Lavazh, parking
- Tregtim artikuj te ndryshem industriale, kinkaleri, cigare etj.

- Transport rrugor udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04.08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njqindmijë)** Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Drita BERISHA, është zotërues e 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 100.000 lekë.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jenë **Znj. Drita BERISHA**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

Drita BERISHA

